



Kosova  
dhuron

2019

# RAPORTI VJETOR PËR GJENDJEN E FILANTROPISË

 CHARLES STEWART  
MOTT FOUNDATION

 catalyst

 Rockefeller  
Brothers Fund  
Philanthropy for an Interdependent World

# Shënime hyrëse/ Pasqyra e përgjithshme

Në vitin 2019, Kosova pësoi një zhvillim pozitiv të disa trendeve të dhurimit. Kjo përfshin rritjen e vlerës totale të regjistruar dhe të kalkuluar, një përqindje më e lartë e mbështetjes strategjike si dhe përmirësim i transparencës së të dhënave. Duke pasur parasysh tërmetin shkatërrues në Shqipëri në fund të vitit 2019 i cili ndikoi edhe në dhënien në Kosovë, këto rezultate janë edhe më të rëndësishme.

Edhe pse njerëzit e Kosovës reagojnë menjëherë ndaj nevojave të Shqipërisë pas tërmetit, niveli i përgjithshëm i dhënies në Kosovë në vitin 2019 nuk pësoi rënie. Përkundrazi, u rrit niveli i donacioneve për qëllime të tjera përveç tërmetit. Përderisa në Shqipëri më shumë se 1.9 milion euro u dhuruan për lehtësimin e pasojave nga tërmeti, shuma e regjistruar e donacioneve për të gjitha qëllimet tjera në vitin 2019 është 2.4 milion euro. Vlera e llogaritur e dhënies në Kosovë për qëllime tjera përveç tërmetit është më shumë se 2.7 milion euro.

Megjithëse edhe dhurimi “i rregullt” edhe dhurimi për lehtësimin e pasojave nga tërmeti janë shembuj të filantropisë lokale, të dhënat do të prezantohen veçmas për të mundësuar krahasimin e tendencave. Të dhënat kyçe për dhënien lokale në vitin 2019 (duke mos përfshirë lehtësimin e pasojave nga tërmeti):



**229**  
numri  
i rasteve  
të regjistruara



**2,7 million €**  
vlera  
e llogaritur  
e donacioneve




**1,5 €**  
donacioni  
mesatar  
për qytetar



**45,6%**  
rritja nga  
viti 2018


Siç u theksua edhe më lart, përveç rënies së numrit të rasteve të dhurimit, dhënia në Kosovë në vitin 2019 pësoi disa tendenca pozitive. Si vlera e llogaritur e donacioneve ashtu edhe shumat e regjistruar patën një rritje të konsiderueshme që nga viti i kaluar, me vlera shumë më të ngjashme me ato në vitin 2017 dhe vitet e kaluara.

Lloji më aktiv i donatorëve ishin individët, ndërsa qytetarët kishin përqindjen më të madhe të vlerës së regjistruar. Dhurimi nga diaspora vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm. Tema kryesore për dhurim në vitin 2019 është arsimi, dhe po ashtu një nga temat më të theksuara në filantropinë e Kosovës për vitin 2019. Individët/familjet ishin pranuesit më të mbështetur përderisa komunitetet lokale kanë marrë përqindjen më të lartë të rasteve të dhurimit. Transparenca e vlerave të dhuruara është 59,8%, e cila paraqet përmirësim në krahasim me vitin 2018.




## Vlerat e llogaritura - tendencat

- vlera e llogaritur e donacioneve (€)
- numri i rasteve të regjistruara



- donacioni mesatar për individ (€)



## Niveli i dhurimit

Aktiviteti i donatorëve pësoi një rënie në krahasim me vitin e kaluar; u regjistruan 229 raste unike të dhurimit. Vlera totale e regjistruar është 2,4 milion euro. Përkundër aktivitetit të zvogëluar, shuma totale e dhurimit është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në bazë të vlerësimit të kryer me kujdes, analizat tregojnë se më shumë se 2,7 milion euro janë dhuruar për të gjitha qëllimet tjera duke mos përfshirë këtu dhurimin për lehtësimin e pasojave nga tërmeti (rritje prej 45,6% në krahasim me vitin e kaluar).

## Shpërndarja gjeografike e donacioneve

Edhe pse pamja e shpërndarjes së mbështetjes pësoi disa ndryshime në krahasim me vitin e kaluar, rajoni i kryeqytetit të Kosovës, Prishtina, vazhdon të marrë përqindjen më të lartë të rasteve të donacionit me 31,4%. Megjithatë, Prishtina pësoi një rënie të konsiderueshme. Në krahasim me vitet e kaluara, mbështetje më e shpeshtë ishte drejtuar për Gjakovën (26,2%). Mitrovica dhe Prizreni pasojnë me pak më shumë se 10%. Rajonet tjera nuk kanë pësuar luhatje të dukshme. Dhënia jashtë Kosovës është pak më e lartë, ndërsa përqindja e rasteve të drejtuara në të gjithë vendin ruajti nivelin e vitit të kaluar.

## Donatorët

Lidhur me shpeshësinë e dhurimit, renditja mbeti e njëjtë si në vitin 2018: donatorët më aktiv vazhduan të jenë individët me një përqindje edhe më të lartë të rasteve të dhurimit këtë vit. Qytetarët janë në vendin e dytë, të ndjekur nga sektori i korporatave. Donatorët e përzier dhe fondacionet private morën pjesë me më pak se 2% të rasteve secili. Përveç donatorëve individual, të gjitha kategoritë e tjera të donatorëve i kanë ulur aktivitetet e tyre. Sa i përket **vlerës së donacioneve**, qytetarët kontribuan më pak këtë vit, por e ruajtën pozicionin e tyre si donatorët më bujarë. Pjesa e donatorëve të përzier vazhdoi të rritet edhe këtë vit. Sidoqoftë, si rezultat i një donacioni të madh nga diasporë, individët pësuan një rritje të konsiderueshme dhe u ngritën në listë, duke e shtyrë sektorin e korporatave në vendin e katërt. Poashtu, vlerat e larta të donacioneve individuale nga diaspora në mënyrë të konsiderueshme e kanë rritur edhe vlerën e përgjithshme të dhuruar.

## Donacionet nga diaspora

Kosova gjithmonë ka një mbështetje të madhe nga diaspora, dhe të dhënat tregojnë që e njehta është duke u rritur këtë vit. 48,9% të rasteve të dhurimit dhe 43,2% e vlerës totale të regjistruar vjen nga donatorët e diasporës.

## Temat

Renditja në listën e katër temave më të mbështetura pësoi disa ndryshime të konsiderueshme në krahasim me vitin e kaluar. Arsimi mori mbështetje më të shpeshtë dhe është tema më e mbështetur për herë të parë që nga fillimi i përcjelljes së filantropisë. Lehtësimi i varfërisë vijon me një rritje të vogël në krahasim me vitin 2018. Përqindja e rasteve të drejtuara për shëndetësinë ka rënë, gjë që ndikohet nga mbështetja më e paktë nga donatorët ndaj personave me probleme shëndetësore për trajtime mjekësore/procedura dhe paisje mjekësore.

Mbështetja e grupeve të marginalizuara ruajti vendin e njejtë.

### **Pranuesit**

Renditja e pranuesve kryesorë ka qëndruar e njëjtë në krahasim me vitin 2018. Pranuesit kryesor në vitin 2019 ishin individët/familjet, me një përqindje të rritur në mënyrë të konsiderueshme të rasteve të dhurimit. Organizatat jofitimprurëse kanë pësuar një rënie graduale të përqindjes së rasteve të dhurimit për dy vitet e fundit. Pas rritjes së përqindjes së rasteve të dhurimeve në vitin 2018, institucionet së bashku me qeveritë lokale/kombëtare këtë vit pësuan rënie.

### **Donacionet për organizatat jofitimprurëse**

Organizatat jofitimprurëse pësuan një rënie të vogël prej 2,3% të rasteve të dhurimit në krahasim me vitin e kaluar, gjë që është një vazhdim i trendit që filloi një vit më parë. Donatorët më aktivë për organizatat jofitimprurëse në vitin 2019 ishin qytetarët. Mbështetja e grupeve të marginalizuara mbetet tema në fokus për organizatat jofitimprurëse, ndërsa personat me aftësi të kufizuara janë përfituesit që mbështeten më shpesh.

### **Donacionet për Shtetin**

Mbështetja më e vogël ndaj shtetit është regjistruar këtë vit, pasi edhe institucionet e qeverisjes lokale dhe nacionale kanë pësuar një rënie në përqindjen e rasteve të dhurimit. Me mbështetje më të fortë nga qytetarët, pamja e donatorëve për shtetin ndryshoi këtë vit. Qytetarët janë lloji kryesor i donatorëve, ndërsa individët dhe sektori i korporatave ndajnë përqindjen e njejtë të rasteve të dhurimit. Tema më e mbështetur përmes donacioneve ndaj shtetit në vitin 2019 ishte shëndetësia

### **Efektet e dhurimit**

Rritja e mbështetjes që ofron efekte afatgjata vazhdon edhe këtë vit, kryesisht për shkak të dhënies së bursave. Megjithatë, edhe pse mbështetja e njëherëshme pati një rënie në përqindjen e rasteve të dhurimit në krahasim me vitin 2018, ky lloj i mbështetjes vazhdon të jetë mbizotërues.


### **Përfituesit**

Renditja e grupeve përfituese më shpesh të mbështetura ka ndryshuar në krahasim me vitin e kaluar. Me një rritje të konsiderueshme në përqindje të popullsisë nga komunitetet lokale, ky grup tani zë vendin e parë. Njerëzit në nevojë ekonomike vijnë të dytët, pasojnë njerëzit me probleme shëndetësore dhe së fundi, njerëzit me aftësi të kufizuara. Vargu i grupeve të tjera përfituese duket gjithashtu e ndryshme pasi disa grupe të reja u shfaqën në listë ndërsa të tjerët nuk ishin në fokusin e donatorëve këtë vit.

### **Transparenca e të dhënave**

Këtë vit, 59,8% e rasteve të dhurimit kishin një vlerë të shoqëruar me ta. Kjo paraqet një rritje prej 8% në krahasim me vitin 2018. Diaspora e Kosovës gjithmonë ka qenë një mbështetje e madhe për njerëzit e Kosovës.

# Donatorët



## Cilët janë donatorët?

Aktiviteti i donatorëve është zvogëluar nga viti i kaluar në 33,4%. Në përgjithësi 229 raste të dhurimit janë regjistruar në vitin 2019. Një numër më i vogël i dhënies për të gjitha qëllimet tjera të zakonshme mund të jetë rezultat i donacioneve për lehtësimin e pasojave nga tërmeti. Megjithatë, kjo nuk pati një ndikim negativ në shumën e dhuruar. Përkundrazi, shumat e regjistruara dhe të llogaritura janë më të larta, kryesisht për shkak të kontributeve nga individët dhe diaspora, që tejkaluan shumat në 2018.

Renditja e donatorëve për sa i përket shpeshësisë së dhënies mbeti në vendin e njëjtë si në vitin 2018. Donatorët individual në mënyrë të konsiderueshme rritën aktivitetin e tyre dhe mbetën më aktivë. Vlen të theksohet që gati 80% nga të gjitha rastet individuale të dhurimit erdhën nga donatorët e diasporës. Të gjitha kategoritë e donatorëve pësuan rënie të vogla më aktivitet. Qytetarët dhe sektori i korporatave ruajtën vendin e dytë dhe të tretë, përkatësisht. Një ulje në aktivitetin e sektorit të korporatave mund të lidhet pjesërisht me uljen e dhënies përmes aplikimeve, gjë që kryesisht bëhet nga

Rastet e regjistruara (%)	2017.		2018.		2019.
Shumica individuale	33,5%	↘	31,4%	↘	28,8%
Sektori i korporatave	13,0%	↗	18,0%	↘	11,8%
Individët	38,3%	↘	32,6%	↗	45,0%
Shuma e regjistruar (në %)	2017.		2018.		2019.
Shumica individuale	35,5%	↗	49,7%	↘	40,9%
Sektori i korporatave	24,2%	↘	8,5%	↔	7,6%
Individët	8,3%	↘	5,6%	↗	17,4%

kompanitë. Këtë vit, është regjistruar vetëm një thirrje për aplikime e shpallur nga sektori i korporatave. Së fundi, donatorët e përzier dhe fondacionet private kanë marrë pjesë po ashtu më rrallë.

Nëse shohim vlerën e donacioneve, qytetarët mbeten donatorët më të fortë në vitin 2019, me donatorët 'e përzier' që marrin vendin e dytë. Për shkak të dy donacioneve të mëdha nga diaspora, dhuruesit individual patën një rritje të konsiderueshme në pjesën e shumës totale këtë vit. Pjesa e donatorëve të tjerë në shumën e regjistruar është zvogëluar. Është e qartë se këto dy ndryshime janë të lidhura – këtë vit janë organizuar më shumë fushata me pjesëmarrjen e donatorëve të përzier (qytetarët, kompanitë dhe shoqatat së bashku). Pjesëmarrja e tyre e përbashkët e bën të pamundur përcaktimin e nivelit të pjesëmarrjes së llojit të veçantë të donatorëve.

Siç u theksua më parë, këtë vit donatorët nga diaspora forcuan dukshëm aktivitetin e tyre si dhe pjesëmarrjen e tyre në vlerat e përgjithshme të dhuruara. Profili i donatorëve të diasporës kryesisht përbëhet nga donatorë individual, ndërsa fokusi i tyre dhe aktivitetet janë sigurimi i bursave dhe ndihmë afatshkurtër siç janë strehimi individual dhe furnizimi me materiale.



## **Mbështetja nga diaspora**

Kishte dy kontribute të rëndësishme individuale nga komuniteti i diasporës që u dalluan këtë vit. Hamdi Lataj nga Nju Jorku, SHBA, investoi EUR 200.000 për riparimin dhe zgjerimin e Shtëpisë së Komunitetit për personat me aftësi të kufizuara intelektuale në Deçan. Falë këtij donacioni, qendra u riparua tërësisht dhe u zgjerua në 200 metër katrorë. Për më tepër, janë krijuar kushte më të favorshme për njerëzit dhe stafin që qëndrojnë dhe punojnë në atë qendër.

Një shembull tjetër i jashtëzakonshëm vjen nga Xhafer Balaj Suedia. Z. Balaj dhuroi paisje në vlerë prej EUR 150.000 për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Obiliq. Me këtë mbështetje, u krijuan kushte më të mira për kontrolle dhe trajtime mjekësore për komunitetin lokal.

Anëtarët e diasporës në të gjithë botën kanë përqendruar ndihmën e tyre më së shumti tek njerëzit në nevojë ekonomike. Diaspora nga Gjermania dhe Zvicra qëndruan bashkë përmes fushatës së nisur nga Shoqata Jetimat e Ballkanit. Qëllimi i fushatës ishte grumbullimi i fondeve për ndërtimin e shtëpive dhe banesave për tetë familje. Vlera totale e grumbulluar nga anëtarët e diasporës dhe e dhuruar tek shoqata ishte EUR 136.895. Diaspora nga Zvicra gjithashtu kontribuoi tek Shoqata Jetimat e Ballkanit përmes një koncerti për grumbullimin e fondeve i cili u organizua në Dietikon, dhe u grumbulluan edhe EUR 104.908 tjera.

## **Kontributet individuale**

Një shembull i shkëlqyeshëm i mbështetjes për temat më pak të zakonshme është dhurimi i profesorit dhe bashkëthemeluesit të organizatës Astronomy Outreach of Kosovo, Milaim Rushiti. Z. Rushiti vendosi të bashkohet me iniciativën e ndërtimit të Observatorit dhe Planetarium të parë në Kosovë duke dhuruar një parcelë tokë për ndërtimin e observatorit. Ky ishte një kontribut i madh në ndërtimin e qendrës së parë astronomike në Kosovë.

Labinot Tahiri ka qenë një shembull i shkëlqyeshëm i kontributeve individuale në Kosovë. Në Ditën Ndërkombëtare të Njerëzve të Shurdhër dhe Njerëzve me Dëgjim të Dëmtuar, këngëtari i dhuroi 1.000 EUR Shoqatës së të Shurdhërve në Prishtinë. Këngëtari gjithashtu dhuroi rrogën e tij prej 1.000 eurosh për Qendrën e Këshillimit në Ferizaj.

## **Donacionet nga fondacionet private**


Këtë vit, Fondacioni Behgjet Pacolli vazhdoi të mbështes sistemin e arsimit të Kosovës. Fondacioni dhuroi televizione, kompjuterë, laptopë dhe pajisje tjera digjitale për Shkollën Fillore Shkëndija në lagjen Hajvali në Prishtinë. Paisjet iu dhuruan shkollës me qëllim të përmirësimit të procesit mësimor si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Fondacioni Behgjet Pacolli ka ndihmuar më parë shkollën Shkëndija duke rinovuar ndërtesën e shkollës.

Njerëzit e famshëm të Kosovës janë mjaft të përfshirë në aktivitete filantropike për të ndihmuar njerëzit e Kosovës në shumë mënyra. Një shembull interesant është evenimenti për mbledhjen e fondeve Festivali Sunny Hill, i cili u organizua nga Dua Lipa dhe babai i saj Dukagjin Lipa përmes Fondacionit Sunny Hill në Prishtinë. Festivali është ngjarja më e madhe kulturore që realizohet në Prishtinë. Tradicionalisht, Festivali Sunny Hill dhe fondacioni mbështesin arsimin, kulturën dhe artin përmes donacioneve në shkolla muzike dhe shkolla të mesme në Kosovë. Këtë vit, 25% të të gjitha fondeve të grumbulluara nga festivali (EUR 150,000) u investua në rinovimin e hapësirave publike të Pallatit të Rinisë në Prishtinë, ku u ndërtuan studiot e regjistrimit për artistë të rinj ambicioz.

# Profilet e kategorive më të zakonshme të donatorëve

## Sektori i korporatave (% e rasteve)

### Top 3 subjektet pranuese



### Top 3 temat për dhurim



### Top 3 grupet e përfituesve përfundimtarë



Interesimi i sektorit të korporatave për subjektet pranuese ka ndryshuar që nga viti i kaluar, duke kaluar nga institucionet (marrësi më i mbështetur i vitit 2018) tek individët/familjet. Një rritje e madhe prej më shumë se 25% në rastet e dhurimit u regjistrua për këtë pranues kryesor. Është e qartë se sektori i korporatave njohu nevojat e individëve dhe siguroi mbështetje kryesisht për lehtësimin e varfërisë - tema së cilës kompanitë dhe NVM përqëndruan mbështetjen e tyre për këtë vit. Përqindja e rasteve të dhurimit të drejtuara si për institucionet ashtu edhe për organizatat jofitimprurëse është më e ulët se vitin e kaluar.

Nëse shohim temat e mbështetura, vërehet që renditja gjithashtu ka ndryshuar. Tema më e mbështetur, lehtësimi i varfërisë, pati një përqindje dukshëm më të lartë të rasteve të dhurimit këtë vit. Sektori i korporatave ka qenë aktiv në fushatat e organizuara për grumbullimin dhe ofrimin e mbështetjes për njerëzit në nevojë ekonomike. Përveç kësaj, shpeshësia e dhënies për arsim është rritur, ndërsa nga ana tjetër, përqindja e rasteve të dhurimit për shëndetësi dhe mbështetjen e grupeve të marginalizuara ka pësuar rënie. Sa i përket grupeve përfituese, renditja po ashtu ka ndryshuar. Për njerëzit në nevojë ekonomike përqindja e rasteve gati është dyfishuar pasi ato ishin në fokus të donatorëve në vitin 2019. Kjo mjaft ka ndikuar tek grupet tjera të cilat patën pak (komunitetet lokale) ose më shumë (njerëzit me aftësi të kufizuar dhe njerëzit me probleme shëndetësore) rënie.

### **Shembuj të donacioneve nga sektori i korporatave**

MTS sh.p.k. Severna Mitrovica ka dhuruar EUR 5.000 për Shoqatën e Prindërve me Fëmijë me Nevoja të Veçanta Support Me Mitrovica, për ndërtimin e qendrës për kujdes ditor Support Me Daycare për më shumë se 130 fëmijë me aftësi intelektuale të kufizuara. MTS sh.p.k. Severna Mitrovica ishte kompania e parë që kontribuoi në ndërtimin e qendrës për kujdes ditor. RAD 028 sh.p.k. Zvečan gjithashtu kontribuoi me EUR 5.000 për Shoqatën e prindërve me fëmijë me nevoja të veçanta Support Me Mitrovica, për ndërtimin e qendrës për kujdes ditor.

Këtë vit, sektori i korporatave ka dhënë mbështetje më shumë përmes fushatave të grumbullimit të fondeve. Argeta DPR dhe Bucaj Company bashkuan forcat dhe themeluan Fondacionin Houses4Kosovo i cili ndihmon familjet në nevojë për të filluar një jetë më të mirë. Me çdo produkt Argeta të shitur, një përqindje e të ardhurave i dhuroheshte fondacionit. Projekti grumbulloi EUR 150.326 për ndërtimin e shtëpive për njerëzit në nevojë. NLB Bank Kosovë mbështeti projektin dhe bëri një donacion për familjen e Remzi Hajrullahit nga Gjilani. Falë donacionit të NLB Bank Kosovë dhe tokës së dhuruar nga Kuvendi Komunal i Gjilanit, familja është vendosur në një shtëpi të re.


Fëmijët ishin katalizatori i mbështetjes së NVM-ve këtë vit, të cilët kanë dhënë kontributet e tyre kryesisht përmes fushatave të mbledhjes së fondeve. Për të katërtin vit me rradhë, Shkolla e Mesme e Prishtinës, një nga shkollat më të mira private në Kosovë, ka mbështetur fëmijët e diagnostikuar me kancer. Shkolla dhuroi EUR 900 për organizatën Care for Kosovo Kids.

## Shumica individuale (% e rasteve)


### Top 3 subjektet pranuese



### Top 3 temat për dhurim



### Top 3 grupet e përfituesve përfundimtarë



Në vitin 2019, individët/familjet janë pranuesit kryesor edhe të dhurimit nga qytetarët. Duke vazhduar trendin nga viti i kaluar, më shumë se 60% e rasteve të dhurimit ishin dedikuar për këto pranues. Kjo mbështetje ishte kryesisht në formë të parave të gatshme për qëllime të trajtimeve mjekësore dhe strehimit individual. Rënditja e tre subjekteve tjera pranuese gjithashtu nuk ka ndryshuar. Është regjistruar aktivitet më i madh ndaj organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve, ndërsa qeveritë lokale/nacionale nuk kanë marrë mbështetje nga qytetarët këtë vit. Në përgjithësi, nivelet e mbështetjes për të gjithë pranuesit kryesorë nuk kanë patur luhatje të ndjeshme në tre vitet e fundit.

Sa i përket temave për dhurim, renditja mbetet e njëjtë si në vitin 2018. Shëndetësia si tema më e mbështetur nga viti i kaluar, si dhe mbështetja e grupeve të marginalizuara. Pavarësisht nga rënia prej

rreth 5%, zvogëlimi i varfërisë mbetet tema e dytë më e mbështetur. Interesimi i qytetarëve për arsim pësoi rënie, pasi mbeti si tema më pak e mbështetur edhe këtë vit.

Në mënyrë të ngjashme, top tre grupet e përfituesve të mbështetur nga qytetarët ruajtën renditjen e njejtë si vitin e kaluar. Mirëpo, për shkak të luhatjeve të konsiderueshme, proporcionet e mbështetjes janë më të balancuara këtë vit.

Megjithatë, të gjitha grupet kryesore të përfituesve pësuan një ulje, përveç komuniteteve lokale, për të cilat qytetarët rritën paksa aktivitetin e tyre dhurues. Një përqindje e dukshme e rasteve u regjistruan për grupe të tjera përfituese më pak të mbështetura, nga të cilat pjesa më e madhe e mbështetjes u shkuan njerëzve në shtete tjera.

### **Shembuj të donacioneve nga shumica individuale**

Qytetarët e Prishtinës këtë vit kanë mbështetur nevojat e grupeve të marginalizuara duke kontribuar në evenimentin e organizuar nga qendra sociale Termokiss. Qendra hapi një treg ku njerëzit kishin mundësi të shesin kryesisht produkte të punuar me dorë. Të gjitha fondet e mbledhura nga produktet e shitura u dedikoheshin grave dhe fëmijëve në rrezik të cilët jetojnë në strehimore. U mblodhën gjithsej EUR 570.

Konsumatorët e rrjetit të Meridian Express kanë treguar përkushtim për të ndihmuar fëmijët pa përkujdesje prindërore në Kosovë. Përmes fushatës Barazo Faturën, konsumatorët e Meridian Express dhuruan pjesën e mbetur të faturave të tyre, duke mbledhur shumën prej EUR 4.941. Kjo shumë iu dhurua SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë. Mbështetja për sistemin shëndetësor erdhi gjithashtu nga diaspora e Kosovës në Gjermani. Përmes veprimit të përbashkët, ato grumbulluan EUR 25.000 për spitalin rajonal në Mitrovicë. Falë donacionit, spitali arriti të përmirësojë shërbimet shëndetësore përmes mbështetjes nga segmente të ndryshme në punët e përgjithshme të spitalit.

# Temat kyçe për dhurim


% e rasteve

**30,6%** arsimi

**27,9%** lehtësime varfërisë

**20,1%** shëndetësia  
mbështetja e grupeve

**14,4%** të marginalizuara



**7,0%** të tjera

**5-10%** dhurimi sezonal

**3-5%** -

**1-3%** -

**0-1%** kulturë dhe art, sport, shkencë

## Trendet - % e rasteve

Temat	2017.		2018.		2019.
Arsimi	10,0%	↗	21,8%	↗	30,6%
Lehtësimi i varfërisë	46,7%	↘	25,9%	↗	27,9%
Shëndetësia	13,7%	↗	25,9%	↘	20,1%
Mbështetja e grupeve të marginalizuara	13,3%	↘	15,1%	↔	14,4%

Në vitin 2019, katër temat kryesore për dhurim mbetën të njëjta – arsimi, lehtësimi i varfërisë, shëndetësi dhe mbështetja e grupeve të marginalizuara, duke mbledhur 93% të të gjitha rasteve të regjistruara. Edhe pse kjo përqindje është më e lartë se vitin e kaluar, nuk është inkurajuese, pasi do të thotë se temat tjera, më pak të mbështetura vazhdojnë të mbështeten më pak se ç'duhet. Gjithashtu, disa nga temat e mbështetura më parë janë zhdukur nga lista, si infrastruktura publike, mjedisi dhe mirëqenia e kafshëve.

Nëse shohim nga afër katër temat kyçe, do të vijmë në përfundimin që gjatë vitit 2019 shënohet një rritje e konsiderueshme në mbështetjen e arsimit. Interesi më i lartë i donatorëve për arsim paraqet një ndryshim shumë pozitiv, pasi arsimi zakonisht ka qenë në fund të listës së temave kryesore të mbështetura. Ndryshimi u ndikua veçanërisht nga rritja e mbështetjes me bursa të dhëna nga një numër donatorësh individualë dhe nga diaspora. Kjo prirje do të ndiqet nga afër në vitet e ardhshme për të identifikuar zhvillimet e mundshme në qasjet më strategjike të donatorëve.

Tri temat e tjera kyçe pësuan luhatje të vogla ose të buta në përqindjet e rasteve. Mbështetja e zvogëluar ndaj kujdesit shëndetësor këtë vit u ndikua nga mbështetja më e rrallë e donatorëve ndaj personave me probleme shëndetësore për trajtime mjekësore dhe paisje për institucionet shëndetësore. Vargu i temave të tjera të mbështetura është e kufizuar me shumë pak. Mirëpo, megjithëse disa nga temat nuk u mbështetën këtë vit, një pjesë e vogël e mbështetjes për shkencën u regjistrua përsëri pas disa vitesh pa asnjë mbështetje.



# Pranuesit

Cilët janë pranuesit?


**69,0%** individët/familjet

**17,5%** organizatat jofitimprurëse

**13,1%** institucionet

**0,4%** qeveritë lokale/kombëtare

**0,0%** të tjera



## Trendet - % e rasteve

	2017.		2018.		2019.
Individët/familjet	63,3%	↘	57,8%	↗	69,0%
Organizatat jofitimprurëse	23,0%	↘	19,8%	↘	17,5%
Institucionet	11,8%	↗	17,4%	↘	13,1%
Qeveritë lokale/kombëtare	1,0%	↗	3,2%	↘	0,4%


Në krahasim me vitin 2018, renditja e katër subjekteve pranuese kryesore nuk ka ndryshuar, me individët/familjet si pranuesit më të mbështetur. Një rritje e konsiderueshme e përqindjes së rasteve të dedikuara për pranuesit individual erdhi si rezultat i mbështetjes më aktive në formën e bursave për fëmijë dhe të rinj, por edhe përmes sigurimit të strehimit individual për njerëzit në nevojë ekonomike. Të dhënat tregojnë se ka po ashtu rritje edhe në përqindjen e rasteve të dhurimit sezonal për individët/familjet. Dhurimi ndaj individëve/familjeve është bërë më së shumti përmes fushatave ose donacioneve direkte si dhe në formë të parave të gatshme.

Dhurim i përforcuar ndaj pranuesve individual ndikoi në dhurimin e donatorëve për të gjithë pranuesit e tjerë. Organizatat jofitimprurëse u mbështetën më rrallë se në vitin 2018. Ndryshimi është mjaft i vogël, edhe pse rënia e numrit të fushatave apo evenimenteve të iniciuara për mbledhjen e fondeve nuk u regjistrua, arsyeja e mundshme për këtë është thjesht drejtimi i një pjese të mbështetjes për individët /familjet. E njëjta vlen edhe për dhurimin ndaj shtetit (institucionet dhe qeveritë lokale/kombëtare) ku regjistrohet një rënie e vogël e aktivitetit të donatorëve.

Sa i përket vlerës së dhuruar, organizatat jofitimprurëse kanë marrë pjesën më të madhe (40,6%). Rritja e lartë e kësaj përqindjeje është ndikuar kryesisht nga mbledhja e suksesshme e fondeve për ofrimin e mbështetjes strategjike për të moshuarit dhe strehim individual për njerëzit në nevojë ekonomike. Pavarësisht rritjes së shpeshtësisë së dhënies së rasteve për individë/familje, pjesa e zvogëluar në vlerën e dhuruar ka të ngjarë të shkaktohet nga fakti që shumë raste janë dhënë në formën të kontributeve në natyrë, për të cilat vlera është më e vogël në masë. Për më tepër, sasi të monetare të dhuruara për institucionet dhe qeveritë lokale/kombëtare u zmadhuan pasi disa dhurues nga diaspora që jepnin vlera të konsiderueshme i drejtuan ato në disa institucione shëndetësore.

# Organizatat jofitimprurëse si pranues

## Temat e mbështetura nga organizatat jofitimprurëse - % e rasteve



Termi organizatë jofitimprurëse vlen për organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e huaja dhe organizatat siç janë UNICEF dhe fondacionet private.

Në krahasim me vitin 2018, organizatat jofitimprurëse morën një nivel paksa të zvogëluar të mbështetjes për sa i përket shpeshësisë së dhurimit. Duke pasur parasysh që mbështetja për individët/familjet është përforcuar në mënyrë të konsiderueshme, është e arsyeshme të mos supozohet ndonjë arsye specifike e zvogëlimit të mbështetjes për organizatat jofitimprurëse, përveçse për ridrejtimin e një pjese të saj tek pranuesit tjerë. Tema më e mbështetur nga organizatat jofitimprurëse vazhdoi të jetë grupet e marginalizuara, të cilat patën një rritje të konsiderueshme këtë vit, përdërisa shëndetësia, zvogëlimi i varfërisë dhe arsimi pësuan rënie. Nga temat më pak të mbështetura, shkenca, e cila përsëri u shfaq në listën e temave të mbështetura në Kosovë, mbështetet në të vërtetë përmes sektorit jofitimprurës. Organizata Astronomy Outreach of Kosova filloi mbledhjen e fondeve për ndërtimin e qendrës së parë astro-

nomike në Kosovë - Observatori dhe Planetarium. Megjithatë, lista e temave është mjaft e ngushtë dhe përveç kësaj përfshin vetëm dhurimin në sport dhe dhurimi sezonal.

Renditja e grupeve përfituese të mbështetura përmes punës së organizatave jofitimprurëse ka ndryshuar. Personat me aftësi të kufizuara patën një rritje të vogël dhe mbetën të parët me gati një të tretën e rasteve të dedikuara për ta. Po ashtu është regjistruar një rritje në grupin e dytë më të mbështetur, popullsia e komunitetit lokal. Dy grupe tjera përfituese kryesore pësuan një rënie të konsiderueshme në shpeshtësinë e mbështetjes përmes sektorit jofitimprurës: njerëzit në nevojë ekonomike të cilët e humbën një nga dy vendet e para të vitit të kaluar, dhe njerëzit me probleme shëndetësore. Nga grupet përfituese më pak të mbështetura, janë regjistruar kontributet për njerëzit që jetojnë në vende të tjera, për fëmijët pa përkujdesje prindërore si dhe nënat dhe foshnjat.

Donatori më aktiv për organizatat jofitimprurëse vazhdojnë të jenë qytetarët me një përqindje të mbështetjes më të lartë se në tre vitet e fundit (42.5% raste të dhurimit). Në rritje e fortë është regjistruar edhe për donatorët individual. Kjo kategori donatorësh zuri vendin e dytë, duke shtyrë sektorin e korporatave më poshtë në listën dhe më afër në nivelin e shpeshtësisë së dhënies si në vitin 2017. Organizatat jofitimprurëse ishin aktive në organizimin e fushatave dhe thirrjeve për mbledhjen e fondeve, të cilat pësuan një rritje në përqindje në vitin 2019. Donatorët më shpesh ishin të gatshëm për mbështetje ndaj fondacionit Action for Mothers and Children, Shoqatës Jetimat e Ballkanit, Shoqatës Nënë Tereza, Shoqatës së Prindërve të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Support Me Mitrovica dhe Shoqatës Qytetare Majka 9 Jugoviça.

### **Partneritete mes korporatave dhe organizatave jofitimprurëse**


Meridian Express ka marrë iniciativë të kontribuojë në mirëqenien e nënave dhe fëmijëve në Kosovë për të dytin vit me rradhë. Kompania ka përkrahur fushatën Eat, Enjoy and Help With Bread and Schärf me donacionin prej EUR 2.040. Fushata u organizua nga fondacioni Action for Mothers and Children dhe ishte e bazuar në produktet e brendit Schärf dhe sanduiçët e Furrës BUKA. Për çdo produkt të shitur të brendit Schärf ose kafe, çaj apo sanduiç të Furrës BUKA, 10% nga vlera u nda për Fondacionin Action of Mothers and Children. Të gjitha fondet e mbledhura në këtë mënyrë u përcollën më pas në Klinikat e Pediatriisë, Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë së Kosovës.

## **Fushata të sukseshme**

Manifestimi vjetor për grumbullimin e fondeve Let's Dance u organizua nga Fondacioni Action for Mothers and Children. Evenimenti organizohet për herë të tretë që nga viti 2015, dhe është shndërruar në një nga traditat më të mira në qytet. Shoqëria tregoi zemërgjerësinë e saj me më shumë se 400 pjesëmarrës. EUR 15.000 u grumbulluan përmes shitjes së biletave, ndërsa sponsorët dhe donatorët dhanë kontributin e tyre prej EUR 13.000. Gjithsej, EUR 28.000 u grumbulluan dhe u përdorën për mbështetjen e programeve për të luftuar sëmundjet e lindjes së parakohshme, vdekjet e foshnjave dhe rrethana të tjera. Fondet u grumbulluan po ashtu edhe për mbështetjen e familjeve me fëmijë me probleme shëndetësore.

# Shteti si pranues

## Top 3 kategoritë e donatorëve - % e rasteve



Dhurimi për shtetin përfshin të gjithë mbështetjen ndaj institucioneve dhe qeverive lokale/kombëtare. Këtë vit, shteti pësoi një rënie prej 7.1% të rasteve të dhurimit në krahasim me vitin 2018, duke u rikthyer në një nivel të ngjashëm si të vitit 2017. Nëse shohim veçmas, të dhënat tregojnë rënien e përqindjes së rasteve të dhurimit edhe ndaj institucioneve (4,3%) edhe të qeverive lokale/kombëtare (2,8%). Sa i përket kategorive të donatorëve, qytetarët ishin më aktiv nga viti kaluar këtë vit, dhe u bënë dhuruesit kryesor për shtetin. Dhuruesit individual e rritën aktivitetin ndërsa sektori i korporatave është në rënie. Është interesante se si donatorët individual ashtu edhe sektori i korporatave ishin po aq aktiv në mbështetjen e shtetit këtë vit me të njëjtën përqindje të rasteve të regjistruara.

Për shtetin, disa nga temat kryesore u mbështetën përmes dhënies ndaj institucioneve dhe jo përmes qeverive lokale/kombëtare. Kjo përfshin shëndetësinë (kryesisht për sigurimin e paisjeve mjekësore), arsim, dhe mbështetja e grupeve të marginalizuara. Qeveritë lokale/kombëtare morën ndihmë vetëm për sferat e kulturës dhe artit. Sa i përket grupeve përfituese, vargu është i ngushtë. Për institucionet, popullsia e komunitetit lokal deri tani ishte më e përkrahura. Njerëzit

me aftësi të kufizuara patën një nivel disi të rritur të mbështetjes në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa njerëzit me probleme shëndetësore kishin një përqindje të zvogëluar. Përveç kësaj, disa ndihma u regjistruan vetëm për të moshuarit. Për qeveritë lokale dhe kombëtare, e gjithë mbështetja u drejtohej fëmijëve dhe të rinjve të talentuar.

Në vitin 2019, raste të shumta dhurimi janë regjistruar për Spitalin e Përgjithshëm Pasjane, Universitetin e Prishtinës, QKUK - Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrën Mjekësore në Mitrovicë.

### **Dhurimet për shtetin/ institucionet**


Korporata më e madhe e karburantit në Kosovë, HIB Petrol, bëri një donacion për shkollën fillore Zenel Salihu në Fushë Kosovë. HIB Petrol furnizoi laboratorin shkollor të kimisë dhe fizikës me pajisjet e nevojshme që u mundësojnë nxënësve në shkollë të kryejnë eksperimente dhe të marrin njohuri praktike. Falë këtij donacioni, nxënësit do të marrin arsim të një cilësie më të lartë dhe do të kenë mundësinë të zbatojnë teorinë që kanë mësuar në praktikë.

### **Mbështetja e komunitetit lokal**

Kompania IPKO ka dhuruar fonde për blerjen e një laboratorit të ri për Qendrën e Mjekësisë Familjare Arbëri në Gjilan. Edhe pse vlera e këtij donacioni është e panjohur, paisjet e dhuruara do të përmirësojnë procedurat e skanimit dhe testimit dhe do t'i bëjnë trajtimet mjekësore më efikase. Klubi Rotarian Prishtinë ndau 1.000 EUR për të pasuruar Bibliotekën Ymer Elshani në komunën e Drenasit. Falë kontributit, biblioteka do të pajiset me libra të reja.

# Kush përfiton nga donacionet?

## Përfituesit përfundimtarë kryesorë - % e rasteve



Lista e katër grupeve kryesore të përfituesve përfshin komunitetet lokale, njerëzit në nevojë ekonomike, njerëzit me probleme shëndetësore dhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Në krahasim me vitin 2018, renditja ka ndryshuar. Njerëzit nga komunitetet lokale kanë marrë donacione më shpesh këtë vit, gjë që i ka vendosur ato në krye



## Trendet - % e rasteve

	2017.		2018.		2019.
Komunitetet lokale	14,3%	↗	24,4%	↗	38,4%
Njerëz në nevojë ekonomike	56,0%	↘	30,8%	↔	30,6%
Njerëz me probleme shëndetësore	8,5%	↗	19,8%	↘	11,8%
Njerëz me aftësi të kufizuara	4,8%	↗	8,1%	↘	7,0%


të listës. Ky ndryshim rezultoi në rritjen e mbështetjes për arsimin dhe paraqet një vazhdim të trendit nga dy vite më parë. Pas rënies së madhe në vitin 2018, mbështetja për njerëzit në nevojë ekonomike tani ruajti nivelin e njejtë; mbështetja jepej më së shpeshti në formën e strehimit individual, direkt ose përmes punës së organizatave jofitimprurëse. Të dhënat tregojnë se ka patur një rënie në përqindjen e rasteve të dhurimit ndaj njerëzve me probleme shëndetësore dhe njerëzve me aftësi të kufizuara. Ndër grupet e tjera përfituese më pak të përkrahura, donatorët ishin më aktivë në ndihmën për njerëzit që jetojnë në vende tjera dhe fëmijët pa përkujdesje prindërore. Sidoqoftë, përqindja e rasteve ndërmjet këtyre grupeve shton në më pak se 2% secila. Kishte gjithashtu disa shtesa në listën e grupeve të tjera përfituese në krahasim me vitin e kaluar. Fëmijët dhe të rinjtë në rrezik kanë marrë përsëri mbështetje këtë vit, si dhe gratë dhe fëmijët viktimat të trafikimit. Nga ana tjetër, këtë vit, donatorët zgjodhën të mos mbështesin popullsinë e papunë dhe kafshët.

Duhet të theksohet se fondet për njerëzit në nevojë ekonomike dhe njerëzit me probleme shëndetësore u grumbulluan kryesisht përmes fushatave të mbledhjes së fondeve, ndërsa komunitetet lokale përfituan nga donacionet direkte në një masë të madhe.

Niveli kumulativ i shpëstësisë së mbështetjes për katër grupet kryesore të përfituesve është më i lartë se viti i kaluar (88.8%), i cili nuk mund të vlerësohet si pozitiv pasi kjo tregon se donatorët nuk janë të interesuar të mbështesin një grup më të gjerë çështjesh me të cilat ndeshen disa nga grupet përfituese. Disa nga çështjet si mbështetja për gratë dhe fëmijët të mbijetuar nga dhuna janë ende "kryesisht të rezervuara" si pjesë e portofolit jofitimprurës. Prandaj, promovimi i përforcuar dhe ndërgjegjësimi për ato grupe dhe çështje është i nevojshëm.

# Efektet e dhurimit

## % e rasteve



## Trendet - % e rasteve


	2017.		2018.		2019.
Mbështetje e njëhershme	73,7%	↘	56,1%	↘	55,0%
Mbështetje afatgjate	19,0%	↗	35,5%	↗	43,7%
Të panjohura	7,3%	↗	8,4%	↘	1,3%

Këtë vit, përqindja e rasteve të mbështetjes që prodhojnë efekte afatgjata u rrit, gjë që paraqet një vazhdim të trendit që filloi në vitin 2017. Ky është një trend shumë pozitiv, veçanërisht kur merret parasysh që mbështetja strategjike ka pësuar rënie në disa vende të tjera të rajonit.

Në dhurimin strategjik, bursat ishin lloji më i shpeshtë i mbështetjes me një rritje prej 18% nga viti i kaluar. Donatorët individualë dhe diaspora ishin jashtëzakonisht aktiv në ofrimin e ndihmës për edukimin e fëmijëve në komunitetet lokale. Dhurimi në formë të pajisjeve ka pësuar rënie në shpeshësi gjë që është ndikuar nga një rënie e interesit të donatorëve për të mbështetur institucionet e kujdesit shëndetësor. Në të njëjtën kohë, mbështetja e njëhershme në përgjithësi pati një rënie të vogël të përqindjes së rasteve të dhurimit. Lloji më i shpeshtë i mbështetjes së njëhershme këtë vit ishte strehimi individual, në 37,3% të rasteve (rritje krahasuar me vitin e kaluar).

Mbështetja me efektet të mundshme afatgjata sigurohet zakonisht nga donatorët individual. Kjo përbën 31,4% të rasteve të dhurimit, gati dy herë më shumë se në vitin 2018. Nga ana tjetër, mbështetja më e shpeshtë e njëhershme ofrohet nga qytetarët me 22,7% të rasteve të dhurimit. Sektori i korporatave nuk ka pasur ndonjë pjesëmarrje të konsiderueshme, duke kontribuar me 3,9% të rasteve të dhurimit strategjik dhe 7,9% të rasteve të mbështetjes afatshkurtër.

## Dhurimi strategjik - % e rasteve



### Shembuj të mbështetjes strategjike

Në fillim të vitit të ri akademik, Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina mori një donacion prej 30 kompjuterësh të rinj nga ndërmarrja Al Trade Holding. Paisjet u dedikuan për nevojat e studentëve në mënyrë që t'i ndihmojnë ata gjatë studimeve të tyre. Në mënyrë të ngjashme, një shembull tjetër i shkëlqyeshëm dëshmon përkushtimin për përmirësimin e ambienteve edukative Dhoma e Tregtisë Amerikane dhuroi paisje për Shkollën Profesionale Adem Gllavica në Lipjan. Donacioni përfshinte paisje teknologjike të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.

Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë kanë organizuar mini maratonën We Run For Knowledge. Pjesëmarrësit e maratonës duhej të blinin një numër në vlerë prej EUR 5. Fondet e mbledhura nga maratona u dedikuan për qendrat për aktivitete jashtëshkollore për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Prishtinë. Këto qendra mësimore janë pjesë e një iniciative më të gjerë, pasi rreth 40 qendra mësimore në 15 komuna të Kosovës janë themeluar përmes bashkëpunimit të qeverive lokale dhe OJQ-ve. Qendrat drejtohen nga gjashtë OJQ dhe operojnë në ambientet e siguruara nga komunat, me qëllimin kryesor për të shërbyer si mbështetje për edukimin e rregullt të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptian.

### Dhurimi përmes thirrjeve për aplikim


Gjatë vitit 2019, në partneritet me Klubin Rotarian Gjilan, AR Katana, një kompani e ndërtimit dhe rimodelimit nga Gjilani filloi fondin për studentët vendas. Janë dhënë 110 bursa për studentë të suksesshëm në këtë komunë. Vlera totale e bursave të akorduara është EUR 15,180.

### Dhurimi për lehtësimin e pasojave nga tërmeti në Shqipëri në vitin 2019


Njerëzit nga Kosova kanë siguruar një mbështetje të madhe për viktimat e tërmetit në Shqipëri. Të dhënat tregojnë se vlera totale e dhurimeve të regjistruara për lehtësimin e pasojave nga tërmeti është më shumë se 1,9 milion euro.

Qytetarët ishin donatorët më aktivë për lehtësimin e pasojave të tërmetit me 39,1% të të gjitha rasteve të dhurimit. Sa i përket vlerës totale të donacioneve, individët ishin kategoria më bujare e dhuruesve pasi ato përbëjnë më shumë se 50% të vlerës së dhuruar. Grafiku më poshtë tregon pjesëmarrjen e kategorive të ndryshme të donatorëve me shpeshhtësinë përkatëse të dhurimit dhe vlerës së përgjithshme të regjistruar.

### Kategoritë e donatorëve




## Pranuesit - % e rasteve




Individët/familjet ishin pranuesi më i mbështetur, i pasuar nga qeveritë lokale/kombëtare dhe organizatat jofitimprurëse.

## Çfarë është dhuruar - % e rasteve



Pjesa më e madhe e dhurimeve ishte në formë të donacioneve në para të gatshme që u mbledhën përmes thirrjeve dhe apeleve për dhurim.

## Lloji i mbështetjes - % e rasteve



Pjesa më e madhe e dhurimit ishte ofruar në formë të mbështetjes humanitare.

# Metodologjia

Ky raport është përgatitur duke përdorur bazën e të dhënave Giving Ballkans i cili mbetet burimi më i besueshëm i të dhënave për dhënien e bamirësisë në rajon. Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, Catalyst Balkans shfrytëzon mënyra alternative për të grumbulluar të dhëna, kryesisht raporte të mediave dhe burime të tjera të gatshme. Gjatë vitit 2019, Catalyst Balkans gjurmoi raportet e mediave mbi individët vendas, sektorin e korporatave dhe filantropinë e diasporës në Kosovë. Raportet e mediave janë mbledhur duke ndjekur mediat elektronike, të shtypura dhe online në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar në Kosovë në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2019. Gjatë kësaj periudhe, gjithsej 767 raste në lidhje me dhënien e bamirësisë nga të gjitha llojet e donatorëve u përpunuan në bazën e të dhënave Giving Ballkans, nga të cilat 229 ishin raste unike. Kjo metodologji ka kufizime të caktuara. Duke përfshirë faktin më të rëndësishëm që mediat nuk i regjistrojnë të gjitha rastet e dhënies së bamirësisë.

Përfundimisht për vitin 2019 ishte tërmeti që ndodhi në vitin 2019. Dhurimi dhe mbështetja ndaj njerëzve të prekur nga tërmeti u përjashtua nga raporti për filantropinë e përgjithshme sepse lehtësimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore përfaqëson një pikë të dhënash që nuk është përfaqësuese e dhënies së vazhdueshme lokale çdo vit, dhe për këtë arsye duhet të paraqitet veçmas. Megjithatë, ne besojmë se hulumtimi ynë siguron një pasqyrë mjaft të besueshme të aspekteve më të rëndësishme të dhënies së bamirësisë sepse shifrat, megjithëse nuk janë gjithëpërfshirëse, ofrojnë një vlerë minimale për treguesit përkatës. Nëse diskutojmë numrin e rasteve bamirëse të regjistruara, mund të themi me siguri se numri që tregojmë është numri minimal i rasteve që kanë ndodhur. E njëjta gjë vlen edhe për shumat e parave të gatshme, aktorët dhe të ngjashme. Prandaj, këto të dhëna mund të përdoren si tregues të shkallës dhe sasisë minimale të zhvillimit të filantropisë në Kosovë.

*Hulumtimi Kosova Dhuron 2019 – Raporti Vjetor për Gjendjen e Filantropisë është pjesë e një nisme më të gjerë për të promovuar dhe nxitur filantropinë një rajonin që përfshin Fondacioni Catalyst. Hulumtimi themelor dhe ky publikim janë krijuar nga Fondacioni Catalyst (Catalyst Balkan) me mbështetjen bujare të Fondacionit C. S. Mott dhe Fondit Rockefeller Brothers.*

*Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit C. S. Mott, Fondit Rockefeller Brothers, ose partnerëve të tyre.*



---

**Catalyst Balkans**  
38 Takovska, Beograd

[catalystbalkans.org](http://catalystbalkans.org)  
[givingbalkans.org](http://givingbalkans.org)

**Përgatitur nga**  
Jelena Bekçiç  
Maja Gligoriç

**Redaktuar nga**  
Aleksandra Vesić Antiç

**Dizajni**  
Luka Kokoviç

Beograd, 2020

**Të dhëna të mbledhura nga**  
Judita Krasniqi

**Përkthimi**  
Adelina Ajdari